



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punëhënë/Prodato. Received/Delivered	01 - 11 - 2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	SKPM/SHK	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
	6814/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1173/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1173/2023 të datës 18.09.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë [redacted], kundër organit të punësimit Ministrisë Financa Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 01.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1173/2023 e datës 18.09.2023 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

Arsyetim

Ankuesja [redacted] e punësuar në pozitën e punës "Zyrtare për Pensione" në Departamentin e Pensioneve, Divizioni për Skema Pensionale Zyra e Pensioneve Prizren në kuadër të Ministrisë Financa Punës dhe Transfereve në bazë të Akt Emërimit me numër AE.Nr.2046/2022 të datës 29.08.2022, me datë 18.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6141/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e pagave retroaktive nga data 25.09.2019 kur

është publikuar njoftimi për kandidatin përzgjedhës nga Divizioni për Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.09.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, ndërsa Këshilli më datë 02.10.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministrisë Financa Punës dhe Transfereve, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 6141/2023 të datës 18.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e ankueses drejtuar Komisionit për shqyrtimin e ankesave të zyrtarëve publik në MFPT me numër protokoli 1581-1/23 i datës 26.07.2023; Kërkesën e ankueses drejtuar zyrës së personelit në MFPT pa datë; Akt Emërim i [redacted] me numër AE.Nr.2046/2022 i datës 29.08.2022; Vendim i KPMSHCK me numër protokoli 2166/2022 i datës 15.04.2022; Konkurs nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për pozitën "Zyrtar për Pensione" i datës 24.07.2019; Njoftim për rezultatin e përzgjedhjes përfundimtare të kandidatit pjesëmarrës në procedurën e rekrutimit të datës 25.09.2019; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 27.09.2023; Përgjigje në ankesë i datës 02.10.2023; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën "Zyrtar për Pensione" pa datë; Vendim i KPMSHCK me numër protokoli 4661/2022 i datës 11.08.2022; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 29.09.2023; E-mail nga A.B. për [redacted] i datës 27.09.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 05.10.2023; E-mail nga D.Z. për [redacted] i datës 04.10.2023; Aktvendim i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me numër A.nr.2238/2022 i datës 19.05.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses, **është e pabazuar sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të administrimit të provave ka gjetur se Zëvendës Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve në zbatim të vendimit me numër A.nr.582/2022 të datës 11.08.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 29.08.2022 ankueses i ka lëshuar Akt Emërimin me numër AE.Nr.2046/2022 për pozitën "Zyrtare për Pensione" në Departamentin e Pensioneve, Divizioni për Skema Pensionale Zyra e Pensioneve Prizren në kuadër të Ministrisë Financa Punës dhe Transfereve dhe e njëjta sipas këtij Akt Emërimi nga data 29.08.2022 ushtron detyrën në vendin e punës "Zyrtare për Pensione" në Departamentin e Pensioneve, Divizioni për Skema Pensionale Zyra e Pensioneve Prizren me koeficient gjashtë pikë pesë (6.5).

Ankuesja pas nënshkrimit të Akt Emërimin me numër AE.Nr.2046/2022, sipas vendimit me numër A.nr.582/2022 të datës 11.08.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.07.2023 ka parashtruar kërkesën drejtuar Komisionit për shqyrtimin e ankesave të zyrtarëve publik në MFPT me numër protokollit 1581-1/23 lidhur me kompensimin e pagave retroaktive nga data 25.09.2019 kur është publikuar njoftimi për kandidatin përzgjedhës nga Divizioni për Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të njëjtit nuk i kanë kthyer përgjigje lidhur me kërkesën e saj.

Ankuesja me datë 18.09.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e pagave retroaktive nga data 25.09.2019 kur është publikuar njoftimi për kandidatin përzgjedhës nga Divizioni për Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke u bazuar në provat e lëndës, konstaton se ankuesja pozitën *"Zyrtare për Pensione"* në Departamentin e Pensioneve, Divizioni për Skema Pensionale Zyra e Pensioneve Prizren në kuadër të Ministrisë Financa Punës dhe Transfereve e ka ushtruar sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.2046/2022 nga data 01.09.2022. Si rrjedhojë e kësaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se përderisa në shkresat e lëndës nuk ka pasur asnjë vendim apo konfirmim zyrtar i cili dëshmon se e njëjta ka ushtruar pozitën *"Zyrtare për Pensione"*, për periudhën për të cilën ankuesja e kërkon kompensimin e pagës nga data 25.09.2019 kur është publikuar njoftimi për kandidatin përzgjedhës nga Divizioni për Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale e deri me datën kur e ka nënshkruar Akt Emërimin, Kolegji i Këshillit vlerëson se pretendimi ankimor i ankueses për kompensim gjatë kësaj periudhe është i pabazuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke iu referuar vendimit me numër A.nr.582/2022 të datës 11.08.2022, ku ka aprovuar ankesën e ankueses të datës 29.06.2022 të parashtruar nga ankuesja Pranvera Dakaj duke obliguar Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë Financa Punës dhe Transfereve që t'ia lëshojë ankueses aktin e emërimit për pozitën *"Zyrtare për Pensione"* në zyrën e pensioneve në Prizren. Andaj bazuar në konstatimin si më lartë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankueses i rrjedhin të drejtat dhe detyrimet prej momentit të themelimit të marrëdhënies së punës sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.2046/2022 të datës 29.08.2022.

Bazuar në konstatimet si më lartë, si dhe duke ju referuar dispozitave ligjore në fuqi, përcaktohet që zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, siç parashihet me nenin 19 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (që ka qenë në fuqi), ndërsa Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, i cili ka qenë në fuqi gjatë periudhës kur ankuesja pretendon se i takon kompensimi përkatësisht neni 9 paragrafi 1, ka përcaktuar se: *"Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës"*, si rrjedhojë meqenëse ankuesja nuk ka pasur asnjë akt juridik që ka ushtruar detyrat e punës së pozitës *"Zyrtare për Pensione"* nga data 25.09.2019 deri me datën kur e ka nënshkruar Akt Emërimin me numër AE.Nr.2046/2022 të datës 29.08.2022, atëherë nuk mund të bëhet asnjë lloj kompensimi për këtë çështje, rrjedhimisht edhe pretendimi i saj për kompensim retroaktiv është i pabazuar.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1173/2023

Çlirim Zeka



Procesmbajtës

Eshref Shabani


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses 
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve;
- Arkivit të KPMSHCK-së.